



A PERSDITA
KOSOVA
11.10.17
08.05.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	05.05.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 66/4
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.27/2017 të dt. 26.04.2017 për lëndën Besnik Xhara Nr.04-353-213724 për ndërtimin e objektit afarist – hotelit në ngastrën kadastrale Nr. 3100.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



212

04.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 27/2017
Datë: 26.04.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i kërkesës/ projektit për ndertimin e objektit afarsit – hotelit në ngastrën kadastrale me numër 3100 – 0 Z.K. Prizren, me kusht që arkitektura e ndërtesës së re të jetë në harmoni me arkitekturën tradicionale – jo imitacion, me pronar Besnik Xharra”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Pala Besnik Xhara nga Prizreni, sipas procedurës së rregulltë, ka parashtruar kërkesën për ndertimin e objektit afarsit – hotelit, në ngastrën kadastrale me numër 3100 – 0. Në një pjesë të parcelës, gjendet skeleti i objektit të ndertuar para disa viteve, i cili sipas projektit do të rrenohet. Objekti i lartëcekur gjendet në Zonën e VIII – të, sipas Planit të Konservimit ku etazhiteti i lejuar është P+2 dhe ku lartësia maksimale deri te streha, është 9.5 m si dhe për ndertim mund të shfrytëzohet deri 60% e sipërfaqës së parcelës.

Në afërsi të parcelës për ndertim, nuk ka ndonjë objekt që është në listën e MKRS “Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme” (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti gjendet në rrugën “Rrasat e Kosharës” p.n.

Sipas planit të konservimit ndërtesat e reja rekomandohet të bëhen me materiale të ngjashme me tradicionale, dhe është e ndaluar që muret e jashtme të vishen me pllaka (qeramike, terakotës, etj) pllaka të lustruara guri, llaç sintetik, alumin, plastikë, xham reflektues, xham i ngjyrosur. Ndaj dhe, Komisioni kërkon që pala gjatë përpilimit të projektit kryesor ti shmangët përdorimit të balustradave me materiale të parafabrikuar dhe ta pasuroj arkitekturën e ndërtesës me karakteristika të arkitekturës tradicionale.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si në vijim:

1. Aprovohet kërkesa e Besnik Xharës për ndertimin e objektit afarsit – hotelit në ngastrën kadastrale me numër 3100 – 0, me kusht që arkitektura e ndërtesës së re të jetë në harmoni me arkitekturën tradicionale për jo imitacion. Hapjet të jenë të proporcionuara dhe të kenë ritëm sipas arkitekturës qytetare,
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në prapë në Komision për verifikim të kushteve

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri

U.D. Drejtor

